



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 450/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxha kryesues, Vllastimir Dimić dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Fryma e Re (FER), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në seancën e panelit të mbajtur me 14.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si e bazuar ankesa e subjektit politik, Fryma e Re (FER)

Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 3000 (tre mijë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 12.12.2010, nga subjekti politik FER, me të cilën pretendohet se më datë 12.12.2010 në ora 10:15, Shpend Lila ka pranuar një mesazh në numrin e telefonit 044102272, nga subjekti politik PDK, në të cilin theksohet “ *Me 12 dhjetor Voto Se Pari Kosovën. PDK nr.49, dhe Voto Blerand Stavileci nr.50*”, që është në kundërshtim me nenin 36 paragrafi 1 pika (a) dhe (b).

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografi si dëshmi, në të cilat shihet qartë dërgimi i masazhit nga subjekti politik PDK. Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i e informoi subjektin politik PDK, më datë 13.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesë deri më datë 14.12.2010, gjerë në ora 12:00. PZAP-i, mori përgjigje në ankesë nga subjekti politik PDK, sipas afatit të caktuar, në të cilën theksohet e kundërshtojmë ankesën për këto arsye:

- Kandidati për deputet i PDK-së, Blerand Stavilevci nuk i ka dërguar mesazh më përmbajtje e lart cekur
- Subjekti politik ankues FER, nuk ofruar asnjë provë se një mesazh i tillë është dërguar nga mbështetësit e PDK-së, apo nga mbështetësit e Blerand Stavilevci
- Ermi “fushatë” nuk është definuar më ligjin për zgjedhjet e përgjithshme të Republikës së Kosovës

- Thirrjet telefonike apo dërgimi i mesazheve nuk të konsiderohet fushatë në kuptimin e përgjithshëm.

Veprimet e Ndaluar Para Procesit të Votimit

36.1 Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë:

a) shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërën nga Qendrat e Votimit, ose 100 metra brenda hapësirës së të njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi tek votuesit;

b) bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se subjekti politik PDK ka thyer heshtjen zgjedhore, gjithashtu PZAP vlerëson se PDK ka përsëritur në lende të mëparshme shkelje të Kodit të Mirësjelljes, rrethanë e cila ndikon në lartësinë e dënimit të shqiptuar në gjobë. Prandaj nga arsyet e lartcekura, në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhór për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 450/2010 më datën 14.12.2010

**Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxha**

